



Nr. Prot. 3500/23, datë: 04.12.2023

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-135 të Republikës së Kosovës për Veprimtari Kërkimore- Shkencore, nenit 148, paragrafit 1 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), nenit 14, paragrafi 1, të Rregullores për Hulumtime Shkencore dhe Subvencionim të Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore dhe Aplikative në UShAF, me nr. prot.: 1612/23; Datë: 19.06.2023, vendimit të Senatit të UShAF nr. 2036/23 të datës 04.08.2023 si dhe vendimit të Komisionit për Hulumtime Shkencore nr. 3429/23 i datës 29.11.2023, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), më datë 04.12.2023, shpall:

THIRRJE:

PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONIMIN E PUNIMEVE SHKENCORE

Të drejtë aplikimi kanë i gjithë stafi akademik i rregullt në UShAF i cili ka publikuar tërësisht ose një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të hulumtimit në revistat shkencore të indeksuara në platformat:

- Clarivate Analytics-Web of Science (SCIE, SSCI, AHCI),
- SCOPUS.

Botimi i veprimtarive shkencore në revista apo shtëpi botuese të dyshimta nuk do të rimbursohen nga UShAF.

Do të merren në konsideratë vetëm punimet e publikuara pas thirrjes së fundit për subvencionim nga ana e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Kërkesa për rimbursim protokollohet dhe dorëzohet në administratën e universitetit brenda afateve të parapara në thirrje.

Kërkesës për aplikim duhet t'i bashkëngjiten:

- Formulari për aplikim, i plotësuar dhe nënshkruar nga autori që bënë kërkesën;
- Dëshmi me të cilën autori konfirmon se punimi i publikuar nuk është financuar nga ndonjë palë tjetër;
- Kopja e punimit të publikuar;
- Dëshmia e pagesës së punimit.

Aplikimi bëhet nga data 04.12.2023 deri me datë 11.12.2023 në ora 15:00. Nuk do të merren parasysh projektet me dokumentacion të pakompletuar dhe të dorëzuara pas afatit.